



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 94

6 qershor

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8199 datë 28.5.2013	Për emërim prokurori.....	3927
Dekret nr. 8200 datë 28.5.2013	Për emërim prokurori.....	3927
Dekret nr. 8201 datë 28.5.2013	Për emërim prokurori.....	3928
Dekret nr. 8202 datë 28.5.2013	Për emërim prokurori.....	3928
Dekret nr. 8203 datë 28.5.2013	Për emërim prokurori.....	3929
Dekret nr. 8204 datë 28.5.2013	Për transferim prokurori.....	3929
Dekret nr. 8205 datë 28.5.2013	Për emërim prokurori.....	3930
Dekret nr. 8206 datë 28.5.2013	Për emërim prokurori.....	3930
Dekret nr. 8207 datë 28.5.2013	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	3931
Dekret nr. 8211 datë 31.5.2013	Për emërim prokurori.....	3931

Dekret nr. 8212 datë 31.5.2013	Për emërim prokurori.....	3932
Vendim i KM nr. 450, datë 23.5.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj. Marjana Prendi.....	3932
Udhëzim i MF nr. 16, datë 31.5.2013	Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 149/2013 “Për miratimin e aktit normativ nr. 2, datë 2.5.2013 të Këshillit të Ministrave “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme””.....	3933
Urdhër i MD nr. 192, datë 8.5.2013	Për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit.....	3936
Urdhër i MD nr. 193, datë 8.5.2013	Për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit.....	3937
Urdhër i MD nr. 194, datë 8.5.2013	Për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit.....	3938
Urdhër i MD nr. 195, datë 8.5.2013	Për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit.....	3940
Vendim i GJK nr. 24, datë 29.5.2013	Me objekt ndreqjen e gabimit në shkrim, në vendimin nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.....	3941
Vendim i ERE nr. 55, datë 29.5.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Koka 1” si burim i rinovueshëm energjie.....	3943
Vendim i ERE nr. 56, datë 29.5.2013	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Dans Energy Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	3944
Vendim i ERE nr. 57, datë 29.5.2013	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	3945
	Kërkesë për vërtetim të faktit juridik për shtetasit Reshat Toptani dhe Dildiruzi Toptani.....	3946

DEKRET
Nr. 8199, datë 28.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17, 18 dhe 43 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Adnan Xholi emërohet prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8200, datë 28.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17, 18 dhe 43 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Alma Muça emërohet prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8201, datë 28.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17, 18 dhe 43 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Altin Binaj emërohet prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8202, datë 28.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17, 18 dhe 43 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Kudusi Shahu emërohet prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8203, datë 28.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17, 18 dhe 43 pika 2 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Madrid Kullolli emërohet prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8204, datë 28.5.2013

PËR TRANSFERIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 pika 1 dhe 43 pika 1 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Alfred Agolli, aktualisht prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, transferohet prokuror në Prokurorinë e Apelit Gjirokastrë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8205, datë 28.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17 dhe 18 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Arjan Përmeti emërohet prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8206, datë 28.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17 dhe 18 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Gëzim Veizi emërohet prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8207, datë 28.5.2013

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejonet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Sokol Ramazan Qerimi
2. Afriola Afrit Qoli
3. Aranit Skender Axhami
4. Evanela Nesti Lapi
5. Arjan Bujar Çiftja
6. Ilir Gjergji Bice
7. Mirjana Hasim Konda (Bonaj)
8. Enxhi Tomorr Hazizaj
9. Xhilda Gëzim Diamanti
10. Engjellushe (Engjëllushe) Zaim Muzaku (Skrapalliu)
11. Emma Loreen Jorgaq Muzaku
12. Manjola Ligor Beinik (Blumbi)
13. Fatbardha Hilmi Askvik (Koka)
14. Merita Baki Petrela (Halili)
15. Renata Eduard Petrela
16. Angela Ndue Saal (Tosku)
17. Feride Adem Elezaj (Shehaj)
18. Chiara Sali Elezaj
19. Klea Sali Elezaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8211, datë 31.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17 dhe 18 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Rovena Gashi emërohet prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8212, datë 31.5.2013

PËR EMËRIM PROKURORI

Në mbështetje të nenit 149, pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 17 dhe 18 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Fatjona Memçaj emërohet prokurore në Prokurorinë e Apelit Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 450, datë 23.5.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
ZNJ. MARJANA PRENDI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 650 000 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të znj. Marjana Prendi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 16, datë 31.5.2013

**PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 149/2013 “PËR MIRATIMIN E AKTIT
NORMATIV NR. 2, DATË 2.5.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 149/2013 “Për miratimin e aktit normativ nr. 2, datë 2.5.2013 të Këshillit të Ministrave “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme dhe të regjistruar në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive, kanë të drejtë që brenda datës 31 tetor 2013, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut. Në kategorinë e pasurisë së paluajtshme përfshihen toka dhe ndërtesa. Procesi i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme është si më poshtë. Nga kjo e drejtë përfitojnë të gjithë shtetasit që zotërojnë pasuri të paluajtshme pa asnjë kufizim.

1.1. Individit paraqet kërkesën për rivlerësim të pasurisë pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive ku është e regjistruar pasuria në pronësi të tij, duke plotësuar formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Individit mund të zgjedhë vullnetarisht nëse rivlerësimin e pasurisë do ta bëjë ZVRPP-ja apo një ekspert i vlerësimit të pasurive i licencuar nga institucionet përkatëse.

1.2. Në rast se rivlerësimi i pasurisë do të bëhet nga një ekspert i licencuar, formularit të aplikimit duhet t’i bashkëlidhet fotokopje e licencës së vlerësuesit të pasurisë, si dhe akt vlerësimi i vlerësimit të pasurisë së nënshkruar dhe vulosur nga vlerësuesi i pasurisë.

1.3. Në rast se individit zgjedh që rivlerësimin e pasurisë do të bëjë zyra vendore e regjistrimit të pasurisë me çmimet minimale fiskale që aplikohen për vitin 2013, në bazë të udhëzimit të përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, udhëzimi nr. 9 datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, të ndryshuar.

1.4 Aplikuesi paraqitet personalisht, me dokument identifikimi pranë ZVRPP-së dhe depoziton në dy kopje formularin e aplikimit te punonjësi i ZVRPP-së. Ky i fundit shqyrton të dhënat e plotësuara në formular dhe dokumentacionin bashkëlidhur (nëse ka). Nëse të dhënat janë të



sakta, punonjësi i ZVRPP-së nënshkruan formularin e aplikimit dhe një kopje të tij ia jep aplikuesit. Nëse ka pasaktësi në plotësim, fton aplikuesin t'i korrigjojë. Punonjësi i ZVRPP-së nuk ka asnjë arsye që të refuzojë kërkesën për aplikim.

a) Tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet 1% e diferencës midis çmimit të rivlerësimit me çmimin e blerjes së pasurisë në kontratën paraardhëse të shitblerjes. Në rastet kur pasuria e paluajtshme e regjistruar në ZVRPP nuk ka një kontratë paraardhëse shitblerjeje, tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet sipas metodikës së përdorur në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008 "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme", të ndryshuar.

Gjatë plotësimit të formularit të aplikimit për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme, zyra vendore e regjistrimit të pasurive llogarit masën e tatimit të rivlerësimit (pika 4 e formularit të rivlerësimit). Aplikuesi paguan në bankë, për llogari të Buxhetit të Shtetit të Ministrisë së Financave, tatimin 1% të rivlerësimit të pasurisë. Tatimi mbi rivlerësimin e pasurisë duhet të paguhet në momentin e kryerjes së aplikimit për rivlerësim. ZVRPP-ja, pasi bashkëlidh formularin e aplikimit për rivlerësim me mandatin e pagesës së tatimit nga aplikuesi, bën ndryshimet përkatëse brenda 10 ditëve në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Data e rivlerësimit të pasurisë është data e pagimit të tatimit të rivlerësimit të pasurisë. Ky ndryshim i njoftohet aplikuesit, sipas kërkesës së tij në ZVRPP, për shërbimin e lëshimit të kopjes së kartelës së pasurisë apo vërtetimit të pronësisë së paluajtshme.

b) Në rast se individi do të bëjë kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme pas rivlerësimit, tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë llogaritet si diferencë e çmimit të shitjes dhe çmimit të rivlerësuar të pasurisë. Në rast se kjo diferencë është negative, individi nuk paguan tatim.

2. Në rast se individi ka në pronësi më shumë se një pasuri të paluajtshme dhe do të bëjë rivlerësimin e secilës prej tyre, procedura e rivlerësimit është individuale për secilën pasuri shpjeguar më lart.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Shtojca nr. 1: Formular Aplikimi për për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme

Tatimi = 1% (cmimi minimal fiskal i vitit 2013 minus cmimi në kontratën e shitblerjes)

Data dhe nënshkrimi i aplikuesit: _____

Aplikimi është marrë nga personi i autorizuar nga ZVRPP:

Adresa e banimit _____
Adresa e dytë (nëse ka) _____

2. Të dhënat e pasurisë së paluajtshme:

Në përputhje me ligjin Nr149/2013, "Për miratimin e aktit normativ nr. 2, datë 02.05.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", aplikoj për rivlerësimin e pasurisë sime të paluajtshme.

Lloji i pasurisë së paluajtshme, (tokë / ndërtesë) _____

Numri i regjistrimit në zyrën kadastrale _____, sipërfaqja në m² dhe me fjalë: _____
m² _____ Data e regjistrimit në ZVRPP: _____

Cmimi i blerjes së pasurisë, bazuar në kontratën e shitblerjes: _____

(në vlerë dhe me fjalë, për t'u plotësuar nga ZVRPP)

3. Rivlerësimi i Pasurisë së Paluajtshme:

3.1. Në rast se kryhet nga eksperti i pasurisë:

Vlera e tregut të pasurisë në vitin 2013 sipas Akt Ekspertimit bashkëlidhur

(në shifra dhe me fjalë)

3.2. Në rast se kryhet nga ZVRPP

Vlera e pasurisë në vitin 2013 sipas cmimeve minimale fiskale të vitit 2013

(në shifra dhe me fjalë)

4. Tatimi për t'u paguar:

Tatimi = 1% (vlera e tregut të pasurisë minus cmimi në kontratën e shitblerjes)

Tatimi = _____

Tatimi = 1% (cmimi minimal fiskal i vitit 2013 minus cmimi në kontratën e shitblerjes)

Data dhe nënshkrimi i aplikuesit: _____

Aplikimi është marrë nga personi i autorizuar nga ZVRPP:



URDHËR
Nr. 192, datë 8.5.2013

PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a” të nenit 6 dhe nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noteri Skënder Gjoci, anëtar i Dhomës së Noterisë Durrës, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 1, datë 27.2.2013, nëpërmjet së cilës kërkon heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, për shkak se i biri i tij z. Alban Gjoci, është shpallur fitues në provimin e kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas nenit 22 të ligjit nr. 7829/1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, plotësimi i vendit vakant që krijohet për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit, i ofrohet nga Ministri i Drejtësisë bashkëshortes/bashkëshortit/ose fëmijëve të tij/saj nëse ata fitojnë mbi 80 për qind të pikëve të konkurrimit ose ushtrojnë profesionin e noterit. Në këtë rast, noteri ka të drejtën të kërkojë t’i dorëzohen regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit që nuk ushtron profesionin e tij.

Me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 126, datë 28.3.2013, z. Alban Gjoci i është dhënë leja e ushtrimit të profesionit të noterit, pranë bashkisë Kavajë.

Bazuar në sa më sipër, lind si e nevojshme heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Skënder Gjoci, për shkak të dorëheqjes së tij, si dhe dorëzimi i akteve dhe i regjistrave të tij noterialë të birit z. Alban Gjoci, për shkak të dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit të noterit pranë bashkisë Kavajë.

PËR KËTO ARSYE,

mbështetur në shkronjën “a” të nenit 6 dhe nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Skënder Gjoci, anëtar i Dhomës së Noterisë Durrës.

II. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Znj. Diana Toro, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

2. Znj. Odeta Dervishi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

3. Znj. Rezarta Koçi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

4. Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

5. Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Durrës.

III. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Durrës. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45-ditor, noterit Alban Gjoci.

IV. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Skënder Gjoci, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

V. Të njoftohen menjëherë: institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

VI. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR
Nr. 193, datë 8.5.2013

PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a” të nenit 6 dhe të nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar

KONSTATOJ:

Noterja Dolores Zaloshnja, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën datë 25.3.2013, nëpërmjet së cilës kërkon heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit për shkak se i biri i saj z. Redion Zaloshnja, është shpallur fitues në provimin e kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas nenit 22 të ligjit nr. 7829/1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, plotësimi i vendit vakant që krijohet për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit, i ofrohet nga Ministri i Drejtësisë bashkëshortes/bashkëshortit/ose fëmijëve të tij/saj nëse ata fitojnë mbi 80 për qind të pikëve të konkurrimit ose ushtrojnë profesionin e noterit. Në këtë rast, noteri ka të drejtën të kërkojë t’i dorëzohen regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit që nuk ushtron profesionin e tij.

Me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 134, datë 28.3.2013, z. Redion Zaloshnja i është dhënë leja e ushtrimit të profesionit të noterit pranë Bashkisë Tiranë.

Bazuar në sa më sipër, lind si e nevojshme heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Dolores Zaloshnja, për shkak të dorëheqjes së saj, si dhe dorëzimi i akteve dhe i regjistrave të saj noterial të birit z. Redion Zaloshnja, për shkak të dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit të noterit pranë Bashkisë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE,

mbështetur në shkronjën “a” të nenit 6 dhe nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar



URDHËROJ:

I. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Dolores Zaloshnja, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë.

II. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Znj. Diana Toro, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

2. Znj. Odeta Dervishi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

3. Znj. Rezarta Koçi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

4. Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

5. Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.

III. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45-ditor, noterit Redion Zaloshnja.

IV. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Dolores Zaloshnja, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

V. Të njoftohen menjëherë: institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

VI. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR

Nr. 194, datë 8.5.2013

PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të shkronjës "a" të nenit 6 dhe të nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noterja Shkëndije Shahu, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 62, datë 11.3.2013, nëpërmjet së cilës kërkon heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, për shkak se i biri i saj z. Helian Zenelaj, është shpallur fitues në provimin e kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas nenit 22 të ligjit nr. 7829/1994 "Për noterinë", të ndryshuar, plotësimi i vendit vakant që krijohet për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit, i ofrohet nga Ministri i Drejtësisë

bashkëshortes/bashkëshortit/ose fëmijëve të tij/saj nëse ata fitojnë mbi 80 për qind të pikëve të konkurrimit ose ushtrojnë profesionin e noterit. Në këtë rast, noteri ka të drejtën të kërkojë t'i dorëzohen regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit që nuk ushtron profesionin e tij.

Me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 135, datë 28.3.2013, z. Helian Zenelaj i është dhënë leja e ushtrimit të profesionit të noterit pranë Bashkisë Tiranë.

Bazuar në sa më sipër, lind si e nevojshme heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Shkëndije Shahu, për shkak të dorëheqjes së saj, si dhe dorëzimi i akteve dhe i regjistrave të saj noterial të birrit z. Helain Zenelaj, për shkak të dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit të noterit pranë Bashkisë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE,

mbështetur në shkronjën a të nenit 6 dhe nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Shkëndije Shahu, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë.

II. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Znj. Diana Toro, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

2. Znj. Odeta Dervishi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

3. Znj. Rezarta Koçi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

4. Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

5. Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.

III. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45-ditor, noterit Helian Zenelaj.

IV. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Shkëndije Shahu, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

V. Të njoftohen menjëherë: institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

VI. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi



URDHËR
Nr. 195, datë 8.5.2013

PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a” të nenit 6 dhe të nenit 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noteri Adem Klari, anëtar i Dhomës së Noterisë Durrës, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 985, datë 13.3.2013, nëpërmjet së cilës kërkon heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, për shkak se i biri i tij z. Ervis Klari, është shpallur fitues në provimin e kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas nenit 22 të ligjit nr. 7829/1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, plotësimi i vendit vakant që krijohet për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit, i ofrohet nga Ministri i Drejtësisë bashkëshortes/bashkëshortit/ose fëmijëve të tij/saj nëse ata fitojnë mbi 80 për qind të pikëve të konkurrimit ose ushtrojnë profesionin e noterit. Në këtë rast, noteri ka të drejtën të kërkojë t’i dorëzohen regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit që nuk ushtron profesionin e tij.

Me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 128, datë 28.3.2013, z. Ervis Klari i është dhënë leja e ushtrimit të profesionit të noterit, pranë bashkisë Durrës.

Bazuar në sa më sipër, lind si e nevojshme heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Adem Klari, për shkak të dorëheqjes së tij, si dhe dorëzimi i akteve dhe regjistrave të tij noterialë të birit, z. Ervis Klari, për shkak të dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit të noterit pranë Dhomës së Noterisë Durrës.

PËR KËTO ARSYE,

mbështetur në shkronjën “a” të nenit 6 dhe 22 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Adem Klari, anëtar i Dhomës së Noterisë Durrës.

II. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Znj. Diana Toro, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

2. Znj. Odeta Dervishi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

3. Znj. Rezarta Koçi, inspektore pranë Drejtorisë së Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

4. Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

5. Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Durrës.

III. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Durrës. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45-ditor, noterit Ervis Klari.

IV. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Adem Klari, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

V. Të njoftohen menjëherë: institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

VI. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

VENDIM
Nr. 24, datë 29.5.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 28.5.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Feta Bundo

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyra Përmbartimore Tiranë

OBJEKTI: Ndreqje gabimi në shkrim, në vendimin nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 80, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe diskutoi çështjen në tërësi:

VËREN:
I

1. Kërkuesi Feta Bundo i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, me objekt: “Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshem”.



2. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 12, datë 16.4.2013, ka vendosur:

“Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm”.

3. Pas zbardhjes së vendimit, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, me objekt: *“Ndreqje gabimi në vendimin nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese”.*

II

4. Gjykata Kushtetuese, pasi administroi vendimin nr 12. datë 16.04.2013, konstaton se janë bërë gabime materiale dhe konkretisht:

- në faqen 3, pika 4, në vend të **“vendim nr. 17, datë 15.3.2005”** duhet të ishte shkruar **“vendim nr. 17, datë 15.3.2006”**;

- në faqen 11 të vendimit, në dispozitiv është shkruar **“vendimit nr. 4894, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”**, duhet të ishte **“vendimit nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë”**.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Ndreqjen e vendimit nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese, si vijon:
- në vend të **“vendim nr. 17, datë 15.3.2005”** do të jetë **“vendim nr. 17, datë 15.3.2006”**;
- në dispozitiv, në vend të **“vendimit nr. 4894, datë 14.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”**, do të jetë **“vendimit nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë”**.
- Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 12, datë 16.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.

VENDIM
Nr. 55, datë 29.5.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“SNOW ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC
“KOKA 1” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “II”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21 datë 18.3.2009, dhe neneve 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 29.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Snow Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues HEC “Koka 1”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Snow Energy” sh.p.k. është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3 , gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Koka 1”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 56, datë 29.5.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “DANS ENERGY ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10 pikat 1, dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.5.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Dans Energy Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Dans Energy Albania” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit e të aplikimit për licencë të shoqërisë “Dans Energy Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 57, datë 29.5.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGIJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe nenit 45, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “f” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Snow Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



KËRKESË

Shtetasi Gëzim Bajaziti, i biri i Myrtos dhe i Dehterit, lindur dhe banues në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: vërtetimin e faktit juridik të vdekjes së shtetasit Reshat Toptani; vërtetimin e faktit juridik të qenies i njëjti person i shtetasit Reshat Toptani me shtetasin Reshat Beu; vërtetimin e faktit juridik të lindjes dhe të vdekjes së shtetases Dilfiruzi Toptani; vërtetimin e faktit juridik të qenies i njëjti person të shtetases Dilfiruzi Toptani me shtetasen Dilfiruzi Beu.

KËRKUESI
Gëzim Bajaziti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 6.6.2013
Doli nga shtypi më 6.6.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë